

Raport i audituesit Ligjor
Për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë fushatës zgjedhore,
25 Prill 2021 për Partia “Demokristiane e Shqipërisë”.

Modeli I raportimit Miratuar
me Vendim nr. 13 datë 06.04.2021 të Komisionerit Rregullator

AUDITIMIT I RAPORTIT FINANCIAR TË FUSHATËS ZGJEDHORE PËR "DEMOKRISTIANE E SHQIPËRISË".

I. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

A. INFORMACIONI LIGJOR

i. Kuadri ligjor

- Ligjin nr.10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe kontabilistit të miratuar" i ndryshuar;
- Standartet ndërkombetare të auditimit;
- Ligjin nr.8580, datë 17.02.2000, "Për partitë politike", i ndryshuar me ligjin nr.90/2017 datë 22.05.2017;
- Ligjin nr.10019 datë 29.12.2008, "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar,
- Vendimin nr. nr. 426, të datës 12 korrik 2021 "Për shpalljen e rezultatit të shortit për emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar (auditues ligjor), të cilët do të kryejnë auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga subjektet zgjedhore për fushatën zgjedhore, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021";
- Udhëzimit nr. 14, datë 09 qershor 2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve "Për caktimin e kriterëve, procedurat për zgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar (audituesve ligjor) dhe kushtet kontraktuale për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë vitit kalendarik dhe subjektet zgjedhore dhe partiaët e tyre në fushatën zgjedhore";
- Formatet e dokumenteve të raportimit të të ardhurave dhe shpenzimeve nga partitë politike, të shpallura në faqen zyrtare të saj <http://kqz.gov.al/dokumentacioni/>

ii. Standardet e kontabilitetit të zbatueshme

- Standartet Kombëtare të Kontabilitetit

B. OBJEKTI I AUDITIMIT

i. Kontrata e shërbimit

- Kryerja e misionit të auditimit ligjor të detyrueshëm të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet e datës 25.04.2021 u krye sipas kontratës të lidhur midis KQZ-së, përfaqësuar nga sekretari i përgjithshëm i KQZ-së, z. Ylli MERKAJ dhe audituese ligjore, znj. Hidajete Kraja (Muçaj) anëtare e IEKA-s, zotëruese e licencës së IEKA-s, me nr. 107, datë 21.12.2021, me NIPT K56424005P.
- Objekti i kësaj kontrate është i përcaktuar në nenin 1 të saj dhe ka të bëjë me kryerjen e auditimit të detyrueshëm të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021, nga subjektet zgjedhore (parti politike që garojnë më vete ose pjesë e një koalicioni, kandidat i propozuar nga zgjedhësit), si dhe partiaë e listave shumëemërore në përputhje me ligjin nr.8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike",

i ndryshuar, ligjin nr.10091¹ datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, si dhe ligjin nr.25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tyre.

ii. Vendimi i KQZ-së

- Vendimi nr. 426, datë 12 korrik 2021 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve që ka shpallur rezultatin e shortit për emërimin e ekspertëve kontabël të licencuar (auditëve ligjorë), të cilët do të kryejnë auditimin të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021, nga subjektet zgjedhore (parti politike që garojnë më vete ose pjesë e një koalicioni, kandidat i propozuar nga zgjedhësit), si dhe partia e listave shumëemërore, solli lidhjen e kontratës së shërbimit me numër protokollit të KQZ-së 6551, datë 24.09.2021, përshkruar më sipër në pikën i.
Me këtë vendim, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve më ka emëruar, me cilësinë e Auditit Ligjor, **të auditoj fondet** e përfituara dhe të shpenzuara nga Partia "Demokristiane e Shqipërisë" gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021.

iii. Përgjegjësitë përkatëse të subjektit zgjedhor dhe audituesit ligjor

iii. a Përgjegjësitë e subjektit zgjedhor

Subjekti zgjedhor është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të të dhënave sipas formatit të standardizuar të raportimit financiar dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e raportit financiar që nuk përmban anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Auditimi ynë do të kryhet bazuar në faktin që personi përgjegjës për financat, të pranojnë dhe kuptojnë se kanë përgjegjësi:

- Për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të raportimeve financiare tip-standart në pajtim me kërkesat specifike të ligjit "Për partitë politike" i ndryshuar, dhe në udhëzimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ-së);
- Për kontrollet e brendshme të atilla që Partia i konsideron të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e raportimeve financiare tip standard të aprovuara nga KQZ-ja për fushatën zgjedhore të dt. 25 prill 2021, pa anomali materiale nga mashtrimi apo gabimi;
- Regjistrin e posaçëm, sipas formatit të miratuar nga KQZ-ja për shumën e fondeve të përfitura nga çdo person fizik ose juridik, si dhe të dhënat që lidhen me identifikimin e qartë të dhuruesit;
- Deklaratat e dhurimit sipas formatit të miratuar nga KQZ-ja;
- T'i japin audituesit:
 - Të drejtën e hyrjes në të gjitha informacionet për të cilat drejtimi I partisë ka dijeni se janë të nevojshme për përgatitjen e raportimeve financiare tip standart, të aprovuara nga KQZ-ja për fushatën zgjedhore të dt. 25 prill 2021, siç janë regjistrimet, dokumentacioni dhe çështje të tjera;
 - Informacion shtesë, të cilin audituesi mund ta kërkojë nga drejtimi për qëllime të auditimit dhe;
 - Të drejtën e komunikimit pa kufizim me personat nga të cilët audituesi e gjykon të nevojshme për të marrë evidencë auditimi.

¹ Në kontratën e lidhur me KQZ-në, është shkruar gabim numri i ligjit 10019 kur duhet 10091

Si pjesë përbërëse e procesit të auditimit ne kërkojmë nga drejtimi, kur është e përshtatshme, edhe nga personat e ngarkuar me administrimin që të marrim, prej tyre konfirmime me shkrim, lidhur me deklaratimet me gojë që do të na bëhen në lidhje me auditimin.

iii. b Përgjegjësitë e audituesit

Auditimi do të kryhet në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike. Si pjesë e një auditimi sipas SNA-ve, ne do të ushtrojmë gjykimin profesional dhe do të mbajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Si rrjedhojë e kufizimeve të vetvetishme të një auditimi, së bashku me kufizimet e vetvetishme të kontrollit të brendshëm, ekziston një rrezik i pashmangshëm që disa nga anomalitë materiale të mbeten të pazbuluara, edhe pse auditimi është planifikuar siç duhet dhe është kryer në përputhje me SNA-të.

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare (raporti vjetor financiar) në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë por, nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojë vendimet e përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

C. PREZANTIMI I SUBJEKTIT ZGJEDHOR TEK AUDITUESI LIGJOR

i. Prezantimi i subjektit zgjedhor

Partia "Demokristiane e Shqipërisë" është e regjistruar në regjistrin e partive politike pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me urdhërin nr. 40/3 dt.11.12.1991 të Ministrit të Drejtësisë me iniciale PDK. Kryetari i partisë është z. Nard Ndoka, financiere e partisë është zj. Ariona Hoxha. Selia e partisë është Rr. Abdi Toptani, (ish-hotel Drini), Tiranë. Partia është e regjistruar pranë organeve tatimore me NIPT K72006001N.

ii. Forma e organizimit dhe menaxhimit.

Organizimi I PDK-së bëhet mbi bazën e njësive territoriale administrative, njësive elektorale ose në nivel kombëtar, mbi bazën e kritereve specifike. Njësitë organizative janë:

- Dega Bashki
- Nëndega Njësitë e qeverisjes vendore "Minibashkitë dhe Komunat
- Seksioni Çdo qender votimi

Organet drejtuese të Partisë Demokristiane të Shqipërisë janë

- Kongresi I Partisë
- Këshilli Kombëtar i partisë
- Kryetari I partisë
- Sekretari I përgjithshëm

D. PARAQITJA E RAPORTIT DHE STRUKTURA E TIJ

- i. Struktura e raportit të auditimit – kërkesat formale, të ardhurat dhe shpenzimet
- o Partia “Demokristiane e Shqipërisë” ka dorëzuar formatin e standartizuar të raportit financiar të fushatës zgjedhore, model i miratuar me vendimin nr.13, datë 06.04.2021 të Komisionit Rregullator, i shpallur dhe në faqen zyrtare të KQZ-së në këtë link [Partia-Demokristiane-e-Shqiperise.pdf \(kqz.gov.al\)](http://Partia-Demokristiane-e-Shqiperise.pdf). Shpenzimet e fushatës zgjedhore 2021 janë përballuar nga fondet e buxhetit të shtetit të arkëtuara në llogarinë bankare të partisë me datë 12 prill 2021 me vlerë 1,479,742 lekë. Struktura e raportit
 1. Informacion për subjektin zgjedhor, përmbledhje financiare dhe deklarata
 - 2.a Të ardhura -Financime Publike
 - 2.b Të ardhura monetare - Financime jopublike
 - 2.c Të ardhura, dhurime në natyrë - Financime jopublike
 - 2.d Të ardhura të krijuara nga vet subjekti – Financime jopublike
 3. Huatë dhe Kreditë
 - 4.a Shpenzimet e partisë
 4. b raportet e kandidatëve
 - 4.b Shpenzimet për mitingjet e fushatës (pasqyrë)
- ii. Komunikimet e adituesit janë bërë me shkrim në rrugë postare me email dhe njëkohsisht me rrjetet sociale të komunikimit WhatsApp, së pari me kryetarin e partisë z. Nard Ndoka, i cili më komunikoj se në vazhdim duhet të kontaktoj me financieren e partisë zj. Arjona Hoxha. Dokumentacioni u dergua paraprakisht me email dhe WhatsApp nga zj. Ariona Hoxha dhe gjate takimit me dt.28.11.2021 na u dorzuan edhe kopjet e tij. Takimet dhe komunikimet janë realizuar që nga data 23.11.2021 deri me daten 10.12.2021.
- iii. Jepet një paraqitje e përgjithshme në lidhje me raportin e financimit të fushatës zgjedhore të kontrolluar: nëse është ose jo në përputhje me kërkesat e raportimit.
- o Raporti i financimit të fushatës zgjedhore është në përputhje me kërkesat e raportimit sipas vendimit nr.13, datë 06.04.2021 të Komisionit Rregullator.

II. **KËRKESAT FORMALE**

A. **PËRMBLEDHJE**

1/ Data e dorëzimit			
	a) dorëzim në formë elektronike	Po	Datë: 25.08.2021
	b) dorëzim fizik	Po	Datë: 25.08.2021

2/ Nënshkrimi			
	Nënshkrimi	Po	Datë: 25.08.2021
3/ Llogaria bankare e posaçme/ Personi përgjegjës i financës			
	a) evidenca e hapjes së llogarisë/ve bankare të posaçme	Po	Nuk është hapur llogari e posaçme sipas nenit 92/2 pika 2. Llogaria ekzistuese është përdorur si llogari për fushatën zgjedhore dhe në këtë llogari janë arkëtuar fonde të përfituara vetëm nga buxheti i shtetit për fushatën, pranë Tirana Bank me IBAN AL 74206111-450000135382050100 në lek.
	b) Dokumenti i lëvizjeve në llogarinë / të bankare (bank statement) që mbulon fushatën zgjedhore	Po	01.01.2020 -21.07.2021
	c) identiteti i personit përgjegjës të financës (financierit)	Po	Ariona Hoxha

B. ANALIZA

a/ Llogaria bankare e vecantë

- **A është unike llogaria bankare (vetëm për qëllime të fushtaës zgjedhore)?**
 - o Subjekti zgjedhor Partia "Demokristiane e Shqipërisë" nuk ka hapur llogari bankare për fushatën zgjedhore për të marrë donacione që kalojnë shumën 50,000 lekë për shkak deklarimeve nuk ka marrë asnjë dhurim nga fonde jopublike.
 - o Llogaria ekzistuese e partisë Demokristiane, pranë Tirana Bank me IBAN AL 74206111-450000135382050100 në lek është përdorur si llogari për fushatën zgjedhore ku janë arkëtuar fondet publike nga buxheti I shtetit dhe shpenzimet për fushatën zgjedhore. Informacioni i shpallur në faqen zyrtare të KQZ-së për numrin e llogarive për fushatën zgjedhore të vitit 2021, jep llogarinë bankare të Partisë Demokristiane tek Tirana Bank, me nr. IBAN-in: [Llogarite-e-posacme-te-partive-politike-kandidateve-te-listave-shumeemerore-kandidateve-te-pavarur-per-fushate-zgjedhore.pdf \(kqz.gov.al\)](#)
 - o Nuk ka deklarime të tjera që kanë të bëjnë me fushatën zgjedhore.
- **A është siguruar i gjithë informacioni? Plotësia e Informacionit**
 - o Nuk ka evidencë të çeljes së llogarisësë posaçme bankare që është përdorur për fushatën zgjedhore Prill 2021.
 - o Partia Demokristiane e Shqipërisë na ka siguruar informacionin në lidhje me lëvizjet e llogarisë bankare ekzistuese të cilën e ka përdorur si llogari për fushatën zgjedhore Prill 2021, llogari pranë Tirana Bank me nr. IBAN AL 74206111-450000135382050100 – Lekë. Informacioni për lëvizjet e kësaj llogarie janë siguruar për transaksionet që

nga data 01.01.2020, pra 16 (gjashtëmbëdhjetë) muaj para fushatës. Sipas deklarimit me shkrim nga organet e drejtimit të partisë nuk ka asnjë llogari tjetër bankare në emër të Partisë Demokristiane të Shqipërisë.

- o Dokumenti i lëvizjeve bankare (bank statement) që Partia kapërdorur gjatë fushatës zgjedhore na është vënë në dispozicion nga financierja e partia "Demokristiane të Shqipërisë" dhe ato përmbajnë lëvizjet nga data 01.01.2020 - 31.12.2020 me te gjitha vlerat zero si për arkëtimet ashtu edhe për pagesat gjatë vitit 2020, si dhe lëvizjet për periudhën 01.01.2021 deri 21.07.2021 të llogarisë bankare, printuar nga banka me datë 21.07.2021. Të gjitha transkacionet që janë kryer nga drejtimi I partisë në këtë llogari janë gjatë muajit prill 2021, në periudhat e tjera nuk ka transaksione bankare.

b/ Personi përgjegjës për Financën/ Financieri

- **Identiteti i personit përgjegjës për financën (Financieri):**

o Personi përgjegjës për financën është zj. Ariona Hoxha me kontribut vullnetar, emëruar nga Kongresi i -të, i Partisë Demokristiane të Shqipërisë me datë me datë 20.12.2016. Nuk ka mospërputhje të mundshme.

- **Përgjegjësi për përgatitjen dhe nënshkrimin e raportit të financimit të fushatës zgjedhore:**

o Nënshkrimi i raportit financiar të fushatës zgjedhore është bërë Kryetari I partisë "Demokristiane të Shqipërisë" z. Nard Ndoka dhe financierja e partisë zj. Ariona Hoxha.

o Përgatitja e të gjithë dokumenteve mbështetëse si më poshtë:

	a) bosh/mungon informacioni	Jo		
	b) dokumentacioni (shqyrtim i shpejtë)			
		Të Ardhurat		
			Financime publike	1,479,742
			Donacione private	
			Financim nga burimet e veta të partisë	
		Huatë/Kreditë		

		Shpenzimet	
		Mitingje/tubime dhe aktivitete në fushatë	610,000
		Materialet promocionale	
		Media	
		Media Sociale	
		Sondazhe	
		Botime/Publikime	
		Shpenzime zyre elektorale	
		Transporti	800,000
		Konsulenca	
		Reklamime në natyre	
		Shpenzime administrative	69,742

III. **TË ARDHURAT**

A. PËRMBLEDHJE

		Sipas raportit të financimit të fushatës zgjedhore	Sipas auditimit të kryer
1/ Financimi publik			
	Fondi i marrë paradhënie	1,479,742	1,479,742
	Data e marrjes së fondit	12.04.2021	12.04.2021
	Kompensimi financiar paszgjedhor		
	Data e marrjes se kompensimit financiar paszgjedhor		
	Diferenca e kthyer		
	Data e kthimit të diferencës		

2/ Donacionet private		
Shuma e përgjithshme e raportuar	0	0
Shuma e donacioneve në para		0
Shuma e donacioneve në natyrë		0
Përgatitet një listë e donatorëve		
Përfshihen të gjitha dokumentet e lëvizjeve në llogarinë/të bankare të posaçme (bank statement)		
Përputhshmëria midis çdo donacioni të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare të posaçme (bank statement) (shuma)		
Përputhshmëria midis çdo donacioni të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare të posaçme (bank statement) (data)		
Përputhshmëria midis çdo donacioni të raportuar dhe dokumentit të lëvizjeve në llogaritë bankare të posaçme (bank statement) (donatori)		
Përputhshmëria mes çdo donacioni në natyrë të raportuar dhe vlerës së tregut (donatori / data)		
A përputhen shifrat në total (të përgjithshme)?		N/A
Respektimi i kufirit të donacionit		N/A
4/ Huatë/Kreditë		
		Nuk ka
Shuma e përgjithshme e raportuar		N/A
Shuma / shuma e huasë / kredisë (për çdo kredi / hua)		N/A
Data e huasë / kredisë dhe data e shlyerjes (për çdo kredi / hua)		N/A
Paraqitja e dokumenteve mbështetëse (kontratat për secilën kredi/hua)		N/A
5/ Marrja/Arkëtimi i të ardhurave		
Të gjithë të ardhurat në para të marra / të mbledhura përmes llogarisë specifike.	Po	Nëpërmjet llogarisë ekzistuese pranë Tirana Bank, llogari e pëdorur gjatë muajit prill 2021.

B. ANALIZA

a/ Financimi publik

- Shuma dhe data e transferimit të pagesave paradhënie dhe paszgjedhore të marra nga shteti: çfarë ndodh nëse pjesa caktuar publike që duhet ndarë pas zgjedhjeve nuk është e mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet zgjedhore → që do të thotë se raporti i financimit të fushatës zgjedhore (dhe llogaria bankare) është në deficit (kundrejt standardeve të kontabilitetit?)
 - o Raporti I financimit të fushatës është deklaruar në total me të ardhura 1,479,742 lekë dhe shpenzime totale 1,479,742 lekë, nuk ka mungesë likuiditeti për shpenzime meqense te ardhurat janë të barabarta me shpenzimet.
- Partia "Demokristiane e Shqipërisë" ka përfutur vetëm fonde publike nga buxheti I shtetit të arkëtuara në llogarinë bankarë të partisë me datë 12.04.2021, me vlerë 1,479,742 lekë.

b/ Financimi nga burimet jo publike

- **Donatorët e lejuar:**
 - o Kontrolli i identitetit të donatorëve dhe lejueshmëria e çdo donacioni të deklaruar; Nuk ka.
 - o Kontrolli i shumës së përgjithshme të donacioneve nga i njëjti donator, në veçanti nëse disa donacione janë bërë në nivel qendror dhe nga një degë e partisë; Nuk ka donacione që mund të mbledhen si shumë e vetmë nga I njëjti donator në qendër dhe në degë.
- **Burimet e palejuara. Nuk ka.**
- **Kontributet në natyrë. Nuk ka.**
 - o **Vlerësimi:**
Dallimi mes kontributit në natyrë (dhe mundësisht) sponsorizimit dhe veprimtarisë vullnetare;
Vlerësimi (rregulli i 10% më të ulët se çmimi i tregut apo mallrave/shërbimeve që arrijnë vlerën më shumë se 50,000 Lekë).
 - o **Kufizimet**
Kontrolli i shumës së përgjithshme nga i njëjti donator, në veçanti nëse disa donacione janë bërë në nivel qendror nga një degë e rretheve të tjera; Nuk ka.

c/ Financime nga burimet e vetë partisë politike. Nuk ka.

d/ Huatë/Kreditë. Nuk ka

- o Partia "Demokristiane e Shqipërisë" deklaron se nuk ka marrë kredi nga asnjë institucion financiar i licensuar si dhe nga ndonje person juridik apo fizik.

IV. SHPENZIMET

A. PËRMBLEDHJE

Shuma e përgjithshme e raportuar							1,4797,42
Respektimi i kufirit të shpenzimit (Shuma e shpenzimeve nuk duhet të jetë më shumë se 3 herë më e madhe se shuma më e lartë që ka marrë një subjekt zgjedhor nga fondet publike për qëllime zgjedhore, në përputhje me nenin 88 të ligjit nr.10019, datë 19.12.200 "Kodi Zgjedhor i R.SH- se", i ndryshuar).					Po		
Shpenzimet e kryera nga Zyra Qendrore e partisë							
	Shpenzimet zgjedhore të deklaruara në raportin e financimit të fushatës zgjedhore	Faturat e paraqitura	Faturat e Përgjithshme	Dokumente mbështetëse që mungojnë	Shpenzime të papaguara	Mospëru thje në lidhje me dokumentet e paraqitura nga furnitorët	Shuma e përgjithshme e shpenzimeve zgjedhore sipas auditimit
Mitingjet/tubime dhe aktivitete në fushatë	610,000	Urdhër Nr. Dt.06.10.2020 I kryetarit Nard Ndoka për shpenzime në fushatë elektorale.	Liste emërore për shpenzimet udhëtim e dieta për fushatën zgjedhore. Dokumenta arke.	Dokumentatimore.			610,000
Materialet promocionale							
Media							
Media Sociale							
Sondazhe							
Botime/Publiki							
Transporti	800,000	Faturë tatimore	Likuidimi me bankë	Nuk ka		Nuk ka	800,000
Konsulenca							
Reklamime në natyrë							
Shpenzime zyre elektorale							
Shpenzime administrative	69,742	Ekstrakti i bankës për komisionet dhe taksa, arke, librezet energji, uji dhe telefon	Arka, ekstrakti i bankës, librezat e likuidimit dhe kontrata e shërbimit.		Nuk ka	Nuk ka	69,742

Shpenzimet e bëra nga degët e partiat							
	Shpenzimet zgjedhore të deklaruara në raportin e financimit të fushatës zgjedhore	Faturat e paraqitura	Faturat e Përgjithshme	Dokumente mbështetëse që mungojnë	Shpenzime të papaguara	Mospërputhje në lidhje me dokumentet e paraqitura nga furnitorët	Shuma e përgjithshme e shpenzimeve zgjedhore sipas auditimit
Mitingjet dhe aktivitetet e fushatës	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka
Materialet promovuese	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka
Media	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk	Nuk ka
Sondazhet e opinionit publik	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka
Botimet	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk	Nuk ka
Transporti	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk	Nuk ka
Konsulenca	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk	Nuk ka
Reklamat në ambientet e jashtme	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka
Administrative dhe të përgjithshme	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka
Shpenzimet zgjedhore							1,479,742
Të gjitha shpenzimet zgjedhore të bëra janë paguar përmes një llogarie të veçantë.							Jo. Janë paguar nga banka e aktivitetit të zakonshëm të partisë dhe me arkë.

B. ANALIZA

a/ Respektimi i kufirit të shpenzimeve të fushatës (është çdo shpenzim që bën një parti ose partiaët e saj për qëllime të fushatë zgjedhore):

- Është respektuar kufiri i përcaktuar për partitë politike dhe shuma e shpenzimeve nuk është më e madhe se vlera e lejuar.; nuk ka fushata të shumfishta të deklaruara, të bëra në nivel qendror dhe në rrethe.

b/ Analiza e të gjithë shpenzimeve të deklaruarra dhe klasifikuara sipas kategorisë, në përputhje me modelin e raportit të financimit të fushatës zgjedhore përbëhet nga 3 zëra

- Shpenzimet e deklaruarra janë për qëllime të fushatës zgjedhore dhe të aktivitetit vjetor si më poshtë:

- | | |
|---|--------------|
| • Aktivitet fushate/Shpenzime personeli | 610,000 lekë |
| • Karburant gjatë fushatës | 800,000 lekë |
| • Energji elektrike | 22,227 lekë |
| • Ujë | 2,166 lekë |
| • Telefoni fikse | 6,000 lekë |
| • komisione bankaere | 13,949 lekë |
| • Taksa vendore | 25,400 lekë. |

Shuma 1,479,742 lekë.

Analiza e shpenzimeve

- Shpenzimeve të llogaritura dhe të përfshira në raportin e financimit të fushatës zgjedhore kanë natyrë të kuptimtë si shpenzime të fushatës zgjedhore.
- Nga totali i shpenzimeve të deklaruarra nga Partia "Demokristiane e Shqipërisë", shpenzime për fushatën janë shpenzimet e karburantit me vlerë 800,000 lekë dhe shpenzimet për aktivitet fushate me vlerë 610,000 lekë. Shpenzimet e tjera janë shpenzime të aktivitetit normal të partisë si ujë, energji, komisione etj për peiudhën e kohës së fushatës.
- Shpenzimet e kryera për aktivitetin e fushates me vlerë 610,000 lekë të kryera nga përfaqsesit e emëruar për bërjen e fushatës. Këto shpenzime janë kryer urdhër të kryetarit të partisë nr.1 prot, datë 06.10.2020 dhe me dokumentacionin e arkës.
- Shpenzimet e fushatës për karburantin janë kryer me faturë tatimore, dhe janë likuiduar me bankë.
- Shpenzimet e aktivitetit të përditshëm gjatë fushatës si uji, energjia dhe telefoni fix, janë kryer me anë të librezave dhe kontratave që ka Partia Demokristiane ka me furnizuesit e shërbimit, komisionet janë shpenzime direkt nga banka dhe taksat vendore me mandatin e bashkise Tiranë.
- Nuk u konstatuan shpenzime të bëra 6 (gjashtë) muaj para datës së zgjedhjeve deri në ditën e zgjedhjeve.

V. PËRFUNDIMI

A. SINTEZA

o Përmbledhja e gjetjeve dhe e përfundimeve

Subjekti zgjedhor Partia "Demokristiane e Shqipërisë" nuk ka hapur llogari bankare të posaçme për fushatën zgjedhore Prie 2021, referuar nenit 92, pika 2 e Kodit Zgjedhor, por ka përdorur llogarinë ekzistuese të aktivitetit normal të partisë dhe nuk ka patur dhe për të regjistruar në këtë llogari të posaçme me vlerë më të madhe se 50,000 lekë.

o Lista e parregullsive të gjetura gjatë procesit të auditimit. Shpenzimet për aktivitetin e fushatës me vlerë 610,000 lekë për shpenzime ditore për ushqim nuk kanë dokumenta tatimore, si faturë tatimore, kupon tatimor apo dëftesë tatimore, mungesa e të cilave mund të gjenerojë minimalisht detyrime tatimor deri në 15% të shumës së shpenzimeve me vlerë 91,500 lekë.

B. PËRFUNDIMI

Opinionit me rezervë

Ne kemi audituar pasqyrat e raportimit financiar për fushatën zgjedhore, për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25.04.2021, të Partia "Demokristiane e Shqipërisë", të cilat përfshijnë pasqyrat sipas formatit të standartizuar, të raportimit financiar për fushatën zgjedhore, në përputhje me Vendimin nr.13, datë 06.04.2021 të Komisionit Rregullator.

Sipas opinionit tonë, me përjashtim të efektëve të çështjeve të përshkruara në seksionin e bazës për dhënien e opinionit me rezervë të raportit tonë, pasqyrat e raportimit financiar për fushatën zgjedhore, për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25.04.2021, të partia "Demokristiane e Shqipërisë", **paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, financimet dhe shpenzimet e fushatës**, në përputhje me ligjin nr.10019, dt.29.12.2008 për "Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë", me ligjin nr.8580, datë 17.02.2000 "Për partitë politike", i ndryshuar, dhe me ligjin nr.25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", si dhe aktet e nxjerra në zbatim të tyre.

Baza për Opinionin me rezervë

Shpenzimet për aktivitetin e fushatës dieta/usqim etj, nuk kanë dokumenta tatimore, mungesa e të cilave mund të gjenerojë minimalisht detyrime tatimore duke filluar nga 15% e shumës së shpenzimeve me vlerë 91,500 lekë .Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare*. Ne jemi të pavarur nga subjekti zgjedhor në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare, raporteve financiare, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë me rezervë.

AUDITUESE LIGJORE

Hidajete Kraja (Muçaj)

Shkodër me dt.10.12.2021